



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Dragashit (Dragash), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Dragashit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

A1 Vonesa në relizimin e kontratës dhe moszbatimi i ndëshkimeve

A2 Klasifikimi i pa saktë i shpenzimeve

A3 Vonesa në pagesën e obligimeve

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Dragashit.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Dragashit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Dragashit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Dragashit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Dragashit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në respektimin e rregulave financiare për pagesën e faturave brenda afateve ligjore, menaxhimin e kontratave, menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, kompletimin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe klasifikimin e saktë të shpenzimeve.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për kontratën kolektive ishte: 45,110€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 29,363€, ndërsa 15,747€ ishin shpenzimet procedurale të gjykatës/përmbartimit, etj.

Raporti i auditimit ka rezultuar gjashtë (6) rekomandime prej tyre tri (3) rekomandime të reja dhe tri (3) rekomandime të përsëritura.

Ne do ta përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Vonesa në relizimin e kontratës dhe moszbatimi i ndëshkimeve

<b>Gjetja</b>	<p>Neni 2 i kontratës Furnizim me barna, material shpenzues mjeksor dhe material stomatologjik për Q.K.M.F Dragash përfshinë kushtet e dërgesës ku afati kohor për dorëzim do të jetë 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e autoritetit kontraktues.</p> <p>Nga kontrata e testuar është konstatuar se furnizimet nuk janë realizuar brenda afatit të paraparë me kontratë. Urdhërblerja ishte lëshuar nga menaxheri i prokurimit më 04.04.2024, por nuk ishte nënshkruar nga Operatori Ekonomik. Megjithatë, furnizimet janë kryer më 01.10.2024, sipas fletëdërgesës, me një vonesë prej rreth pesë muajsh. Përkundër kësaj vonese, autoriteti kontraktues nuk ka llogaritur dhe nuk ka zbatuar gjopa ndaj operatorit ekonomik, ashtu siç parashihet me kushtet kontraktuale.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së ndjekjes efektive të afateve kontraktuale nga ana e zyrtarëve përgjegjës dhe moszbatimit të klauzolave për ndëshkim në rast vonese.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Moszbatimi i ndëshkimeve për vonesa cenon parimin e barazisë dhe disiplinës kontraktuale, si dhe mund të nxisë praktika të ngjashme nga operatorët ekonomikë në të ardhmen. Kjo mund të ndikojë në mungesën me kohë të furnizimeve të nevojshme mjekësore, duke rrezikuar funksionimin efikas të QKMF-së.</p>
<b>Rekomandimi A1</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që njësitë përkatëse të zbatojnë në mënyrë të rregullt kushtet kontraktuale, përfshirë monitorimin e afateve të dorëzimit dhe aplikimin e menjëhershëm të ndëshkimeve në rast të vonesave si dhe është e domosdoshme që urdhërblerjet të nënshkruhen dhe formalizohen në përputhje me rregullat, për të garantuar një zbatim të drejtë të kontratave nga zyrtarët përgjegjës.</p>

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Klasifikimi i pa saktë i shpenzimeve

<b>Gjetja</b>	<p>Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.</p> <p>Në tetë raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendime përmbartimore, me vlerë totale prej 67,110€, Komuna i ka regjistruar shpenzimet në kategori të gabuar ekonomike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 9,900€ janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime (2 raste),</li> <li>• 1,210€ nga komunalitë (1 rast),</li> <li>• 34,000€ nga investimet kapitale (4 raste), ndërsa këto shpenzime</li> </ul>
---------------	--

kanë qenë për paga jubilarë dhe shujta, që duhej të klasifikoheshin si shpenzime për paga dhe medijtje.

- Gjithashtu, janë paguar 22,000€ nga mallra dhe shërbime, për punë ndërtimore që në natyrë janë investime kapitale.

Këto gabime kanë ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit të saktë buxhetor për këto lloje detyrimesh në kategorinë përkatëse.

#### Ndikimi

Shpenzimet e realizuara nga kategori të pasakta ndikojnë në mbivlerësim apo nënvlerësimin e kategorive buxhetore, duke sjellë pasqyrim jo të saktë të shpenzimeve në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF).

#### Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet e saktë buxhetore, ose të bëhet ridestini i mjeteve kur është e nevojshme, në mënyrë që të gjitha pagesat të regjistrohen sipas kodeve të duhura ekonomike të planit kontabël.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A3 - Vonesa në pagesën e obligimeve

#### Gjetja

Neni 37.2 dhe neni 39 Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP), përcakton që ZKF i OB është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës pas pranimit të faturës, si dhe të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Obligimet e papaguara për vitin 2024 në total arrijnë shumën prej 97,751€ që krahasuar me vitin paraprak ka rënje prej 14,672€. Bartje të obligimeve të papaguar kemi vërejtur edhe në periudhën paraprake. Këto obligimi i përkasin kategorive ekonomike, investime kapitale, mallra dhe shërbime si dhe subvencione.

Kemi vërejtur se në detajet e raportit për detyrimet (faturat) e pa paguara është e evidentuar një faturë e vitit 2023 e cila ende nuk është paguar dhe ka vonesë në pagesën e saj.

Me testimin e katër (4) pagesave nga kategoria e investimeve kapitale dhe dy (2) pagesave nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe një (1) pagesë nga kategoria komunalitë kemi identifikuar se janë ekzekutuar pagesa në bazë të vendimeve përmbarimore/gjykatave. Sipas vlerës së testuar të këtyre mostrave kemi vërejtur se në emër të pagave për shujta/paga jubilarë janë paguar 45,110€ në këtë vlerë përfshihet përveq borxhit prej 29,363€ edhe shpenzime tjera shtesë për procedura përmbarimore së bashku me interesa në vlerë 15,747€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mospagesës me kohë të detyrimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë, përfshirë edhe shujtat nga zbatimi i kontratës kolektive, për të cilat nuk ishte bërë planifikim në buxhet.

#### Ndikimi

Si pasojë e vonesave në pagesa, komuna rrezikon të përballet me kosto shtesë për interesa, gjopa apo shpenzime gjyqësore të kërkuara nga palët e treta.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të forcojë kontrollet financiare dhe të sigurojë hartimin e një analize të detajuar buxhetore, në mënyrë që të gjitha obligimet të paguhen me kohë dhe të shmangen vonesat.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVFe pasurive kapitale është 43,342,853€, pasurive jokapitale është 1,594,447€, si dhe e stoqeve 19,500€.

#### Çështja B1 - Mangësi në evidentimin e pasurisë

##### Gjetja

Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu sipas nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rreg. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore.

Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Komuna kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe komisionet i kishin hartuar raporte individual të pasurive nën 1,000 € për çdo njësi organizative të komunës dhe një raport të përmbledhur për pasuritë mbi 1,000 €, mirëpo nuk kishin përgatitur një raport të përgjithshëm të inventarizimit.

Po ashtu komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000 € në e-pasuri kjo ka ndodhë për arsye se komuna ka bërë disa shkresa në drejtim të MAPL-së dhe ka pasur disa takime për ta rregulluar sistemin, por nuk ka pasur efekt.

Në testimin e pasurive mbi 1,000€ nuk kemi vërejtur pasuri të cilat nuk janë regjistruar në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000 € janë prezantuar në PFV në vlerë totale prandaj, nuk ishte e mundur të identifikohesh se cilat pasuri ishin regjistruar dhe a është përllogaritur zhvlerësimi i tërë pasurisë. Pasuritë nën 1,000€, të prezentuara në PFV për vitin 2024 ishin 1,594,447€, me një rritje krahasuar me vitin e kaluar për 167,821€.

##### Ndikimi

Mos regjistrimi individual i të gjitha pasurive me detajet e tyre si dhe mos përllogaritja e zhvlerësimit rezulton në prezantim jo të drejtë të PFV dhe mbivlerësim të vlerës së tyre. Mungesa e një raporti të përmbledhur të inventarizimit që përmbanë të gjitha pasuritë e Komunës, pamundëson vërtetimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive.

##### Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna e Dragashit në RVF e vitit 2024 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,673,568€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,401,549€, tatimi në tokë 187,043€ dhe shfrytezimi i prones komunale 84,976€.

### Çështja B2 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna në PFV e vitit 2024 ka shpалosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 1,673,568€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,401,549€, tatimi në tokë 187,043€ dhe shfrytezimi i prones komunale 84,976€, vetëm tatimi në pronë është rritur për 46,771€ në krahasim me vitin 2023.

Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme është mospërbushja e detyrimeve ligjore nga ana e komunës për ndjekjen dhe mbledhjen e borxheve tatimore.

**Ndikimi** Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitort mund të shkaktoj probleme në përbushjen e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përbushin obligimet.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Përveç planit strategjik, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte hartuar edhe planin vjetor të punës për vitin 2024, i cili përfshinte katër auditime. Të gjitha auditimet e planifikuara janë realizuar gjatë vitit, dhe ato janë përqendruar në këto fusha kryesore: pasuria, subvencionet, prokurimi dhe shpenzimet. Auditimet kanë mbuluar kryesisht periudhën e vitit 2024. Gjatë këtij viti, Komiteti i Auditimit është mbledhur katër herë, ku janë shqyrtuar raportet e NJAB-së si dhe çështje të tjera që lidhen me punën e këtij institucioni.

#### Çështja B3 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

**Gjetja** Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit public, neni 5.1.1 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë se paku tre auditor.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Dragashit, përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njesisë së auditimit dhe nuk ka anëtar tjerë si auditor të brendshëm.

Komuna nuk ka ndërmarre veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përberjës dhe funksionit të Njesisë së Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur.

**Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB-së, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohe sa me të hershme.

**Rekomandimi B3** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshem sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollat e brendshme.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikeve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>12,110,967</b>	<b>12,606,125</b>	<b>12,415,698</b>	<b>10,990,130</b>	<b>9,023,760</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	11,646,517	11,642,580	11,526,631	10,212,979	8,004,787
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	71,063
Të bartura nga viti i kaluar	0	229,516	207,788	191,599	310,958
Të hyrat vetanake	464,450	464,450	457,800	423,897	443,951
Donacionet vendore	0	3,722	721	18,396	0
Donacionet e jashtme	0	265,857	222,757	143,259	193,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 495,158€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë 299,516 dhe donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 269,578€ dhe shkurtimet të grantit Qeveritar në vlerë 3,937€

Në vitin 2024, Komuna e Dragashit ka shpenzuar 98.5% e buxhetit final ose 12,415,698€, me një rritje afër 13% krahasuar me vitin 2023.

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>12,110,967</b>	<b>12,606,125</b>	<b>12,415,698</b>	<b>10,990,130</b>	<b>9,023,760</b>
Pagat dhe mëditjet	5,819,434	5,815,497	5,814,725	5,502,589	4,465,619
Mallrat dhe shërbimet	1,292,967	1,305,747	1,233,214	1,148,879	1,075,646
Komunalitë	200,000	200,000	198,986	148,244	124,527
Subvencionet dhe transferet	300,000	360,000	357,341	410,610	388,437
Investimet Kapitale	4,498,566	4,924,881	4,811,433	3,779,807	2,969,531

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 495,158€. Kjo rritje është rezultat kryesisht i shtesave në investimet kapitale dhe subvencioneve dhe transfereve.

Shpenzimet kryesore janë realizuar në këto kategori:

- Buxheti final për paga dhe shtesa , krahasuar me buxhetin fillestar, është ulur për 3,937€. Kjo ulje ishte me vendim të Qeverisë së Kosovës. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në afër 100% të buxhetit dhe përbëjnë 46.8% të shpenzimeve totale dhe janë rritur me afër 6% krahasuar me vitin 2023.


- Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 12,780€. Ky ndryshim është i lidhur me të hyrat vetanake dhe donacionet. Shpenzimet për këtë kategori kanë arritur në mbi 94% të buxhetit dhe përbëjnë 10% të shpenzimeve totale dhe janë rritur me 7. % krahasuar me vitin paraprak.

- Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur i njëjtë me atë fillestar, 200,000€. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori ka qenë mbi 99% dhe përbëjnë afro 2% të shpenzimeve totale dhe janë rritur me 34.% krahasuar me vitin e kaluar.

- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur krahasuar me buxhetin fillestar për 60,000€. Kjo rritje është financuar nga të hyrat vetanake. shpenzimet kanë arritur në mbi 99% të buxhetit dhe përbëjnë afro 3% të shpenzimeve totale dhe janë zvogëluar me 13% krahasuar me vitin 2023.

- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 426,315€ krahasuar me buxhetin fillestar. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i përdorimit të të hyrave vetanake dhe donacioneve të jashtme. Shpenzimet kanë qenë afër 98% të buxhetit dhe përbëjnë afro 39% të shpenzimeve totale dhe janë rritur me 27.% krahasuar me vitin paraprak. Vlen të ceket se Thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbartimore/gjyqësore kishte paguar 691,419€,

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2024 ishin në vlerë 442,235€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksa për regjistrimin e automjeteve, të hyrat nga qiraja etj. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2023, ishin më të ulëta për 12.42% apo për 62,701€.

Po ashtu, Komuna për vitin 2024 kë pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë 74,457€ të cilat alokohen për shpenzim në baza të rregullta tremujore. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mësipërme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme po ashtu, nuk janë përfshirë as të hyrat nga gjobat e shqiptuara nga gjykatat, në vlerë prej 1,205€, dhe të hyrat nga Agjencioni i pyjeve në vlerë 7,965€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>464,450</b>	<b>464,450</b>	<b>442,235</b>	<b>504,936</b>	<b>536,896</b>
Të hyrat tatimore	333,940	333,940	251,945	324,438	296,378
Të hyrat jo tatimore	130,510	130,510	187,759	180,498	240,330
Të hyrat tjera	0	0	2,531		189

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Komunës së Dragashit (KD) ka identifikuar pesë (5) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KD ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar. Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, dy (2) nga rekomandimet ishin zbatuar me sukses, ndërsa tri (3) ende nuk janë zbatuar. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të shtojë kontrollet lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale duke vlerësuar të gjitha kontrata. Njëherit të sigurojë së dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim bëhet sipas kërkesave të ligjit për shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Janë zvogëluar obligimet e papaguara krahasim me periudhën paraprake.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.  
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna Dragashit

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Dragashit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshtatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bexhet Xheladini

Pozita: (Kryetar i Komunes),

Data: 26.05.2025,

Nënshkrimi:

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.